



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
SENATI AKADEMIK

Nr. 1408/3 prot.

Elbasan, më 17 .06./2025

VENDIM

Nr. 55....., datë 17 .06./2025

"PËR PËRSHTATJE KUOTASH NË PROGRAMIN E STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË TË STUDIMEVE MASTER I SHKENCAVE NË INFERMIERI NË FAKULTETIN E SHKENCAVE MJEKËSORE TEKNIKE PËR VITIN AKADEMIK 2024-2025"

Bazuar në Ligjin Nr. 80 /2015 datë 22. 07. 2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, neni 69, pika 3, në Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018, pika 2.7/b të ndryshuar "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL", në Vendimin nr. 27, datë 23.02.2024 të Senatit Akademik të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" "Mbi miratimin e kuotave të pranimit në programet e studimit me karakter profesional në programet e studimit të ciklit të dytë Master profesional dhe Master i shkencave për vitin akademik 2024-2025, në zbatim të Udhëzimit Nr.12, datë 30.06.2023, "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar, duke ruajtur numrin e përgjithshëm të kuotave për secilën kategori brenda njësisë kryesore, Senati Akademik,

VENDOSI:

1. Miratimin e përshtatjes së kuotave në programin e studimit të ciklit të dytë të studimeve Master i shkencave "Infermieri" për vitin akademik 2024-2025 në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike, pa ndryshuar numrin e përgjithshëm të kuotave në këtë program studimi, sipas tabelës nr.1, dhe nr.2, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim t'i përcillet Qendrës së shërbimeve Arsimore për procedura të mëtejshme. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Prof. Dr. Elvira FETAHU

